



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

N J O F T I M

**PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR TË MATURANTËVE NË KUADËR TË
PRANIMIT NË PROGRAMIN MJEKËSI E PËRGJITHSHME NË UNIVERSITETIN
E MJEKËSISË, KATEGORITË E VEÇANTA**

Ju informojmë se në datën **16.09.2026**, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: *Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH)*, do të zhvillohet testimi i informatizuar në kuadër të pranimi në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, kategoritë e veçanta.

Faturën për arkëtim për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të QSHA www.qsha.gov.al, në linkun:

https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2025/11/Fatura_provime.pdf

Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, maturantët duhet të kenë parasysh dhe të jenë të pajisur me:

- dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë);
- faturën origjinale të pagesës së tarifës së testimit për llogari të QSHA-së;
- të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;
- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të testimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e testimit;
- firmosin deklaratën e rezultatit të marrë.

Kalendari i organizimit të testimit dhe orari i pjesëmarrjes në testim për çdo maturant, do të publikohennë vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore <http://www.qsha.gov.al/>

Orari i pjesëmarrjes në testim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Kandidati ka të drejtë të ankimojë rezultatit, duke paraqitur ankesën me shkrim, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore brenda 1 (një) dite nga shpallja e rezultatit të testimit të informatizuar.

Ju urojmë Suksese!